

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rusia godet Kievin disa orë pasi të dërguarit amerikanë u larguan nga kryeqyteti ukrainas
ADRESA	https://dosja.al/bota/rusia-godet-kievin-disa-ore-pasi-te-derguarit-amerikane-u-larguan-nga-kryeq-i513077
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:32:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 12:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d01f7da0f03462df5184b6e92f4f449befde95faa7128336e640eddb0723eef4
TEKSTI	c6a4759403d242b0986a2f20caf5085670560e6b953080f4768c63fd77656d8f
PAMJA	10ff6b788ee401d8d2275bb2c149b867f5d02710a271ef1322046fcef99b5f8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	92e825fccde7f2b95230b533d589048909a561c4e1d1170783047913148ed9e5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/92e825fccde7f2b95230b533d589048909a561c4e1d1170783047913148ed9e5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

2 ORE ME PARE

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

3 ORE ME PARE

Reforma e re territoriale/ Rama përplaset me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj: Qepeni gojën

9 ORE ME PARE

Të shtëna me armë zjarri në Mat/ Gjendet e djegur makina e autorëve, shënjestra ishte Akil Lleshi, makina e të birit u qëllua me 35 plumba

9 ORE ME PARE

"Vetë zot, vetë shkop"/ Ngërçi me pagat e gjyqtarëve, shpërthen Rama: Do nxirrnin dhëmbët për të shumëfishuar rrogat! KLP e KLGJ, shëmbëlltyra e errët e reformës në drejtësi

Bota

Rusia godet Kievin disa orë pasi të dërguarit amerikanë u larguan nga kryeqyteti ukrainas

Të paktën 10 persona u plagosën, njoftuan autoritetet e emergjencave.



8 Shtator 2026, 14:55
Nga E.d



Foto ilustruese

Rusia e goditi kryeqytetin ukrainas me raketa balistike, duke vrarë të paktën dy persona, në një sulm të madh disa orë pasi të dërguarit e Shtëpisë së Bardhë u larguan nga Kyevi, në një kohë kur përpjekjet për rifillimin e negociatave të paqes janë intensifikuar.

Sulmi i 8 shtatorit erdhi pas një pezullimi në sulmet pothuajse të përditshme, të cilat kanë nënvizuar synimin e Rusisë për të vazhduar luftën e saj mbi 4-vjeçare kundër Ukrainës, pavarësisht humbjeve astronomike.

Punonjësit e emergjencave nxorën trupa nga rrënojat në një lagje të Kievit, ndërsa zjarrfikësit luftuan për të shuar zjarret e shkaktuara nga sulmi, i cili përfshiu edhe dronë me motorë aeroplanësh - një armë e fuqishme kundër së cilës Ukraina ka pasur vështirësi të mbrohet.

Të paktën 10 persona u plagosën, njoftuan autoritetet e emergjencave.

Sulmi rus përfshiu dhjetëra raketa balistike dhe lundruese, si dhe më shumë se 160 dronë gjatë natës, tha ushtria ukrainase.

Gjatë javës së fundit, Rusia ka kryer sulme pothuajse të përditshme ndaj Ukrainës. Aftësia e Ukrainës për t'u mbrojtur nga këto sulme është kufizuar rëndë për shkak të mungesës së penguesve të raketave, mbi të gjitha të sistemeve Patriot të prodhuara nga SHBA-ja.

Sulmi ndodhi disa orë pasi të dërguarit amerikanë, Steve Witkoff dhe Jared Kushner, u larguan nga Kyevi, pas takimeve me presidentin ukrainas, Volodymyr Zelensky, dhe zyrtarë të tjerë. Para Kievit, dyshja kishte vizituar Moskën, ku zhvilloi bisedime me presidentin Vladimir Putin.

Përpjekjet e SHBA-së për të shtyrë përpara negociatat e paqes kanë qenë të pezulluara muajt e fundit, pasi

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 12:07

Analiza: Si po përdoret IA-ja
për sigurinë në shkollat e
Shqipërisë

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 09:45

Detaje nga të shtënat me armë
në Mat/ Reth 30 gëzhoja
gjenden në vendngjarje,
pronarët e mjetit të djegur
sapo ishin kthye nga Italia

Uashingtoni i ka dhënë përparësi luftës kundër Iranit, e cila tani ka hyrë në muajin e gjashtë.

Ministri i Jashtëm ukrainas, Andriy Sybiha, u bëri thirrje aleatëve të Kievit "të veprojnë dhe të rrisin presionin ndaj agresorit".

Ministria ruse e Mbrojtjes tha se sulmi kishte në shënjestër objekte të mbrojtjes dhe të logjistikës ushtarake ukrainase.

Ambasadorja e Bashkimit Evropian në Ukrainë, Katarina Mathernova, tha se e kaloi natën në një strehimore, ndërsa "Kievi po shpërthente dhe digjej" gjatë sulmit rus.

"Ajo që ndodhi në Kiev mbrëmë ishte ferr", shkroi ajo në X. "Nuk do t'ia uroja askujt që jeton në paqe dhe bie në gjumë i sigurt në shtratin e vet".

Fundjava shënoi herën e parë që Witkoff dhe Kushner udhëtuan në Kiev për bisedime. Witkoff është takuar me Putinin tetë herë që nga fillimi i vitit 2025.

Pas takimit me Zelenskyn, Witkoff i përshkroi diskutimet si konstruktive dhe tha se Uashingtoni kishte dëgjuar "ide të reja" nga Moska. Kushner tha se Shtetet e Bashkuara po punonin për një "paketë më të gjerë paqeje".

Zelensky, nga ana e tij, i quajti diskutimet e tij me amerikanët "shumë substanciale" dhe tha se Ukraina ishte e gatshme të ecte përpara drejt bisedimeve trepalëshe që do të përfshinin Kievin, Uashingtonin dhe Moskën.

Këshilltarët për sigurinë kombëtare të Britanisë, Francës dhe Gjermanisë gjithashtu morën pjesë në një pjesë të diskutimeve në Kiev.

Ukraina ka sinjalizuar se është e gatshme të zhvillojë një tjetër takim me zyrtarë rusë dhe amerikanë, diçka që nuk ka ndodhur që nga viti i kaluar.

Kremlini, megjithatë, nuk ka dhënë asnjë shenjë se ka zbutur qëndrimin e tij të ashpër lidhur me synimet e luftës. Në komentet për gazetarët pas takimeve të 5 shtatorit me Putinin, këshilltari i Kremlinit për politikën e jashtme, Yury Ushakov, tha se Rusia do të vazhdonte përpjekjet për të "eliminuar", siç u shpreh, "shkaqet rrënjësore" të konfliktit.

"Shkaqet rrënjësore" është një term që përfshin një sërë ankesash dhe pretendimesh ruse që datojnë që para pushtimit të vitit 2022, përfshirë pretendimin se Zelensky nuk është president legjitim dhe se qeveria ukrainase po shtypte rusishtfolësit vendas në Ukrainë./REL

rusi sulme ukraina

Sondazh

Poll

DO I A L3 NEWS/UKR 2025, 07:34

Kremlini sjell në front reliktet e një princi të shekullit të 14-të

më të klikuarat

"Qepeni gojën"/ Debate për shkrirjen e bashkisë, Rama përplasat me banorët e Policanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj! Qytetarët largohen nga takimi

Nga "Taken" te Thethi/ TikTokeri, me 4 milionë ndjekës, që i tregoi botës një Shqipëri tjetër

Të shtëna me armë zjarri në drejtim të një automjeti, gjendet e djegur edhe një makinë

Detaje nga të shtënat me armë në Mat/ Reth 30 gëzhoja gjenden në vendingjarje, pronarët e mjetit të djegur sapo ishin kthye nga Italia

insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti

Powered by tomorrow

8 Shtator 2026, 14:47

Shtetasi amerikano-iranian lirohet nga burgu në Teheran, por nuk mund të largohet nga Irani

TEHERAN- Shtetasi amerikano-iranian Kamran Hekmati është liruar nga burgu famëkeq Evin në Teheran, kanë thënë burime pë...

Nga zyrtarët e lartë tek "Ujqit e Natës", REL Kush e përcolli Ratko Mlladiçin?

Bota

8 Shtator 2026, 13:46

Zelensky sheh mundësi për uljen e tensioneve me Rusinë gjatë dimrit: Putin nuk dëshiron të zemërojë Trumpin

Bota

8 Shtator 2026, 09:27

Monumenti rus që shkaktoi zemërim në Japoni

Bota

8 Shtator 2026, 09:06

VIDEO/ Shpërthen baza ushtarake në Bolivi, humbin jetën shtatë persona, shtatë të tjerë të zhdukur

Bota

8 Shtator 2026, 08:44

Bota

7 Shtator 2026, 22:56

Macron kërkon ndalimin e rrjeteve sociale për të rinjtë nën 15 vjeç në Evropë, kërkohet mbrojtje e privatisë

Emmanuel Macron FRANCA- Presidentu francez Emmanuel
Macron i ka kërkuar Komisionit Evropian hartimin e një kuadri të
përbashkët li...

Ish-shefi i Forcave të Mbrojtjes së Izraelit, akuzon Netanyahu se po vendos mbijetesën politike mbi sigurinë e Izraelit

[Bota](#)

7 Shtator 2026, 22:52

Trump kërcënon të ndalojë shitjen e avionëve 'Bombardier': Është mjaftueshëm në SHBA

[Bota](#)

7 Shtator 2026, 22:02

Përkallëzim i ri Moskë-Berlin, Rusia urdhëron mbylljen e Konsullatës gjermane në Shën Petersburg

[Bota](#)


7 Shtator 2026, 19:19

Moska hakmerret ndaj Berlinit, mbyll Konsullatën Gjermane në Shën Petersburg

[Bota](#)

7 Shtator 2026, 18:50

MË SHUMË



Përplasjet e Ramës me banorët e Poliçanit, qytetari: U
soll si sulltan, u tha qepeni gojën

[▶ Shiko video te tjera](#)



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [\[email protected\]](#)



[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#)

MBUNDËSIAR NGA Mediodesk

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.